



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivery	03.08	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANS/OK	5506	/2023	1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.836/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.836/2023 të datës 12.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit KD.nr.22/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.836/2023 e datës 12.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.nr.22/2023 i datës 16.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, më datës 12.04.2023 ka nxjerr Urdhër për Fillimin e Hetimeve duke e themeluar komisionin prej tre anëtarëve me qëllim të hetimit të zbardhjes së rastit të pranimit të detyrës respektivisht armës dhe municionit MP-5. Komisioni prej tre anëtarëve më datë 13.04.2023 ka përgatitur raport me të cilin konstatohet se gjatë pranimit të detyrës në këtë rast ka pasur shkelje pasi që nuk është verifikuar nëse pranimi i armës është bërë në rregull ngase dy fishek të armës kanë qenë të dëmtuar ndërsa pranimi është bërë kinse gjithçka është në rregull dhe se ankuesi duke mos pritur që pranim

dorëzimin e detyrës ta bëjë në karakoll tek zyrtari korrektues I.K ka bërë shkelje të rregullave të punës për zyrtarin korrektues.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren më datë 18.04.2023 për këtë rast është inicuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit, pranë Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 16.05.2023 ka nxjerr Vendim KD.nr.22/2023 me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore "ndalimi i 20% e pagës për periudhë tre (3) muaj".

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 08.06.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 12.06.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.836/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.06.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 20.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Më datë 24.07.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendim me numër protokoli 5340/2023 me të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes së ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 4706/2023 të datës 12.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 08.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 20.06.2023; Kontratë për kohë të pacaktuar e ankuesit e datë 15.07.2020; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Zyrtar Korrektues; Raportin e Komisionit i datës 13.04.2023; Urdhrin për fillimin e hetimeve i datës 12.04.2023; Informatën me Nr. 448/23 të datës 10.04.2023 nga K.L; Informatën me Nr. 447/2023 e datës 10.04.2023 nga Sh.P; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 18.04.2023; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 11.05.2023 dhe 13.05.2023; Deklaratë me Nr. 446/23 e datës 10.04.2023 nga ankuesi; Informatën me Nr. 449/23 e datës 10.04.2023 nga I.K; Shkresë me titull Vërejtje; Dëshmi për pranim detyrës; Udhëzim për rregullat e punës për oficerin e karakollit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren i datës 14.06.2022; Udhëzim për instruksionet e Drejtorit për Stafin me Nr. 50/2022 i datës 11.05.2022; Fotot e predhës; Vendimin KD.nr.22/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e *pabazuar, sepse:*



Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.22/2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se më herët nuk ka pasur ndonjë masë disiplinore për këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se më datë 10.04.2023 pranimi/dorëzimi i armës MP5 nuk është bërë në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me rregullat e brendshme lidhur me pranim/dorëzimin e armës të përcaktuar me aktet e Qendrës së Paraburgimit në Prizren, ndërsa ankuesi në deklaratën me numër Nr. 446/23 të dhënë me datën 10.04.2023 thekson „se kur ka dorëzuar detyrën konkretisht armën nuk ka vërejtur që predhat kanë qenë të dëmtuara dhe këtë e ka kuptuar vetëm nga zyrtar I.K dhe jam kthyer nga rruga dhe kur kam ardhur ne karakoll kam parë që dy fishek nuk kanë qenë në rregull”, ndërsa në seancë të Komisionit Disiplinor të datës 11.05.2023 ankuesi ka deklaruar që pranim/dorëzimin e detyrës e ka bërë jashtë karakollit respektivisht tek shkallët, duke theksuar se kam bërë është shkelje.

Sipas Rregullave të Punës për Oficerin Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prizren të datës 14.06.2022 është paraparë se: *“Oficeri i karakollit është përgjegjës për sigurimin e armës së zjarrit MP5 dhe municionit në karakollë. Oficeri i Karakollit duhet të mbikëqyrë edhe pjesën e rrethuar afër kuzhinës, ku të burgosurit e angazhuar në kuzhinë qëndrojnë kohë pas kohe dhe të monitorojë lëvizjet e tyre”*, rrjedhimisht sipas Instruksioneve të Drejtorit për Stafin me numër reference 50/2022 të datës 11.05.2022 për Qendrën e Paraburgimit në Prizren lidhur me vendosjen e armës së gjatë të zjarrit MP5 në karakoll është përcaktuar se: *“Çdo herë gjatë pranimit dhe dorëzimit të detyrës duhet verifikuar nëse arma është në gjendje të rregullt dhe municioni është i saktë në numër dhe kjo duhet vërtetuar përmes formularit adekuat i cili do të qëndroj gjatë tërë kohës në karakoll. Mbikëqyrësi i lartë kujdestar/Mbikëqyrësit kujdestar në çdo pranim dorëzim të detyrës do të verifikoj nëse forma e pranim dorëzimit të armës është e mbushur dhe nënshkruar nga oficerët dhe ta vërtetoj këtë duke e shkruar emrin dhe mbiemrin si dhe nënshkrimin e tij në formularin e njëjtë në rubrikën përkatëse. Për çfarëdo parregullsie gjatë pranimit-dorëzimit oficeri i karakollit raport tek Mbikëqyrësi i lartë/Mbikëqyrësi kujdestar. Në asnjë moment oficeri i karakollit nuk guxon të largohet nga karakollin pa njoftimin e mbikëqyrësi të lartë kujdestar dhe zëvendësimin adekuat të tij”*.

Kolegji i Këshillit, gjatë analizimit të këtyre rregullave të brendshme, konstaton se obligimi i zyrtarëve korrektues është që pranim/dorëzimi i armës duhet të bëhet brenda në karakoll dhe po ashtu duhet të verifikohet nëse gjithçka është në rregull si me armen po ashtu edhe me predhat e saj, rrjedhimisht në këtë rast nuk është bërë pranim/dorëzimi i armës në mënyrë të rregullt sipas rregullave në fuqi po ashtu nuk janë shikuar predhat e saj nëse gjithçka është në rregull.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh provat materiale të lëndës, dispozitat në fuqi, dhe vetë faktin se ankuesi ka pranuar që ka bërë gabim gjatë pranimit/dorëzimit të armës, konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm*



dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”, si dhe përshkrimin e detyrave të punës, po ashtu i njëjti ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar me dispozitat e 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër KD.nr.22/2023 i datës 16.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, është në pajtim me nenin 45, 47, 48 dhe 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe i njëjti është i ligjshëm kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.836/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

